



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 33-2008
Prishtinë, 22 dhjetor 2008, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Kolë Berisha, Adem Hajdaraj, Armend Zemaj dhe Ibrahim Makolli.

Munguan: Branisllav Gërbiq, Bajram Kosumi, Selvije Halimi dhe Xhezair Murati.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit në mbledhje ishin të pranishëm: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Në mbledhje morën pjesë: nga OSBE - Ramadan Islami dhe Lejla Selimi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 14 nëntorit 2008,
3. Shqyrtimi i Draftregullores së punës të Kuvendit,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari në fillim të mbledhjes i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falënderoi organizatat që e mbështesin punën e Komisionit. Shpreson se kjo mbështetje do vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm. I njoftoi të pranishmit se kjo do të jetë mbledhja e fundit e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për vitin 2008. I njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 14 nëntorit 2008

Kryetari i pyeti anëtarët e Komisionit a kishin vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Draftregullore së punës të Kuvendit

Kryetari - Lidhur me shqyrtimin e Draftregullore së punës të Kuvendit dha sqarime se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi i ka dy mundësi për ta shqyrtuar këtë draftregullore nen për nen, të bëjë amendamente aty ku ka vërejtje dhe t'i paraqesë rekomandime Komisionit Funkcional për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës.

Ibrahim Makolli - Tha se kjo draftregullore kërkon shqyrtim të tërësishëm, sepse mbështetet pjesërisht në Kornizën kushtetuese të Kosovës dhe pjesërisht në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo draftregullore ka mjaft mangësi, saqë nganjëherë po mendoj se Rregullorja, që është ende në fuqi, është më e mirë. Shtoi se ne si komision i veçantë duhet ta shqyrtojmë nen për nen dhe t'i paraqesim Kuvendit amendamente, jo rekomandime për Komisionin Funkcional.

Kryetari - Ishte i mendimit se Draftregullorja duhet të shqyrtohet nen për nen. Shtoi se do të bëhen amendamente aty ku vërejmë se ka mangësi dhe paqartësi. Këto amendamente do t'ia paraqesim Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës. Ky komision mund t'i inkorporojë këto amendamente, në mënyrë që ne në Kuvend t'i paraqesim si amendamente të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kryetari – E filloi shqyrtimin e Draftregullore prej nenit 1. Në fillim tha se duhet të shtohet fjala *e punës* dhe të jetë: *miraton Rregulloren e punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, sepse mbështetemi edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky propozim u përkrah edhe nga anëtarët e tjerë të Komisionit.

Anëtarët e Komisionit kishin vërejtje edhe për rregullën 2, në të cilën parashihet vula e Kuvendit dhe thuhet se Kuvendi e ka vulën e vet zyrtare.

Armend Zemaj - Tha se fjala *zyrtare* duhet të hiqet, sepse Kuvendi e ka vetëm një vulë. Nga kjo nënkuptohet se nuk mund të jetë edhe një vulë tjetër. Po ashtu tha se në rregullën 2.2, *forma dhe përmbajtja e vulës së Kuvendit përcaktohet, duhet të jetë në pajtim me Ligjin për vulat në institucionet e Republikës së Kosovës.*

Kjo rregull u diskutua edhe nga anëtarët e tjerë të Komisionit dhe u vendos të mos ndryshohet, pasi u konstatua se formulimi ishte i mirë.

Kryetari - Kishte vërejtje të rregulla 5, në të cilën janë përkufizimet. Tha se këtë e ka thënë edhe në seancë, kur është debatuar për Draftrregulloren. Duhet të kërkohet që këto përkufizime të jenë pjesë përbërëse të Rregullores dhe të shkruhen të gjitha, jo të jenë shtojcë e Rregullores.

Ky propozim u mbështet nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

Gjithashtu Komisioni kishte vërejtje të rregulla 7. Për këtë rregull u debatua gjatë.

Kryetari - Propozoi që për këtë rregull të mbështetemi në nenin 66.3 të Kushtetutës. Për këtë mori mbështetje nga anëtarët e Komisionit, me vërejtjen që përsëri të diskutohet në Komision.

U diskutuan edhe për rregullat: 8 - që ka të bëjë me përgatitjen e seancës konstituive, 9 - që ka të bëjë me kryesimin e mbledhjes konstituive dhe 13 - që ka të bëjë me përbërjen e Kryesisë.

Kryetari - Tha se në rregullën 14.5, shkarkimi i kryetarit të Kuvendit ose i anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit, me propozim të partisë politike ose të grupit, që i ka emëruar, bëhet sipas procedurës së zgjedhjes së tyre. Propozoi që *partia politike* të hiqet dhe të mbetet *me propozim të grupit parlamentar të partisë politike.*

Ibrahim Makolli - Kishte vërejtje të detyrat e Kryesisë së Kuvendit, në rregullën 15.8, sepse Kryesia nuk duhet ta bëjë zgjedhjen e sekretarit të Kuvendit. Pati vërejtje dhe për rregullën 15.10.

Kryetari - Propozoi që sekretarin e Kuvendit ta zgjedhë Kuvendi. Me këtë propozim u pajtuan edhe anëtarët e tjerë të Komisionit.

Ibrahim Makolli - Tha se do të bëjë vërejtje dhe se amendamentet e tij do t'i paraqesë nëpërmjet grupit parlamentar.

Komisioni vendosi që shqyrtimi i mëtejshëm i Draftrregullores të vazhdojë në mbledhjen e radhës të Komisionit.

4. Të ndryshme

-Përfundim nga Kryesia e Kuvendit për Projektrezolutën për dënimin e krimeve komuniste

Në pikën e rendit të ditës, të ndryshme, kryetari i Komisionit tha se e kemi përfundimin nga Kryesia e Kuvendit për Projektrezolutën për dënimin e krimeve komuniste. Për të para një jave na e kanë prurë një përfundim që të bëhet deklaratë financiare për këtë rezolutë, kurse tash Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, së bashku me Kryesinë e Kuvendit, ta bëjë harmonizimin e tekstit të kësaj rezolute.

Lidhur me këtë kishte pakënaqësi ndër anëtarët e Komisionit. Ata ishin të mendimit se kjo ishte punë e Komisionit e jo e Kryesisë së Kuvendit, si dhe për miratimin ose mosmiratimin e saj duhet të vendosë Kuvendi, sipas propozimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E hartoi stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit
Bahri Hyseni